# DËSHMI ARKIVI

**A-459122**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Irani ekzekuton një person të dënuar për spiunazh, akuzohej se i dha Mossadit të dhëna për bazat raket ore |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/irani-ekzekuton-nje-person-te-denuar-per-spiunazh-akuzohej-se-i-dha-mossadi-i587183` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 20 shtator 2026, 06:53:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 07:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f56b4b99f972d4a29d0910230cf7a5dfb6291713dc47b3dd177860e877369575` |
| TEKSTI | `bebdec6bc4d8f9109c975b365eef233e36cdb1a5946ef8fa89259c4464623ba4` |
| PAMJA | `0f6e4a9e5d78388bc25faeb0557646d8d7d15a48ddd263b7b3d101a0828afcdd` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `125922c45e73237d96b94ae6fc1be4ff07f9fb01726683e70048fe83cf0fece5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/125922c45e73237d96b94ae6fc1be4ff07f9fb01726683e70048fe83cf0fece5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Irani ekzekuton një person të dënuar për spiunazh, akuzohej se i dha Mossadit të dhëna për bazat raketore

TemA
20 Shtator 2026, 09:00Bota TEMA



Autoritetet iraniane kanë ekzekutuar Hossein Pedaranin, pasi ai ishte dënuar përfundimisht për spiunazh dhe bashkëpunim me shërbimin izraelit të inteligjencës, Mossad, raportojnë agjencitë iraniane.

Pedarani akuzohej se u kishte dorëzuar agjentëve izraelitë të dhëna tepër konfidenciale për lokacione të rëndësishme ushtarake dhe sisteme raketore në provincën Isfahan. Gjatë kontrollit në shtëpinë e tij, hetuesit gjetën dhe sekuestruan pajisje të koduara, si dhe pajisje të fshehura për regjistrim.

Agjencia zyrtare iraniane e drejtësisë, Mizan, publikoi detaje nga dëshmia e tij. Sipas këtij raporti, Pedarani fillimisht kishte tentuar të kontaktonte CIA-n amerikane, duke u ofruar për bashkëpunim, por pasi nuk mori përgjigje, iu drejtua Mossadit.

Disa ditë më vonë, ai mori përgjigje nga një person i inteligjencës që u prezantua si "Ben" dhe përdorte një numër telefoni holandez në aplikacionin WhatsApp.

Shërbimet iraniane pretendojnë se Pedarani kishte rivendosur kontaktin me Mossadin përmes aplikacionit Telegram pas shpërthimit të luftës 12-ditore, pak para se të arrestohej në Isfahan nën akuzat që lidhen me këtë konflikt.

Pas përfundimit të procesit gjyqësor, ai u dënua me vdekje për spiunazh dhe bashkëpunim me një shtet armik. Gjykata Supreme e Iranit e konfirmoi dënimin, pas së cilës u krye edhe ekzekutimi, raportojnë agjencitë Tasnim dhe Mizan.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Komandanti amerikan: Mbi një miliard fuçi naftë u transportuan përmes Ngushticës së Hormuzit]

08:50 Bota

[Eksperti përdori ChatGPT për raportin në gjyq, gjykata e përjashton nga dëshmia]

08:40 Bota

Sulm masiv me dronë në Rusi, goditet një rafineri pranë Moskës! Dy viktima dhe mbi 30 fluturime të pezulluara

08:20 Bota / 1 koment

Trump hap sondazh, propozon ndryshimin e emrit të Inteligjencës Artificiale

08:02 Bota / 2 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.